

Sok Kon



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E FINANCËS DHE E BUXHETIT

Nr 4647 prot.

Gramsh, më 21 /11/2023

RELACION

“Për dhënien e ndihmës financiare Zj.Enkeleda Tafa”

Mbështetur në Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar në ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar ligjit Nr.84/2022 datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” i ndryshuar ligjit 139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore “ si dhe kërkesës me Nr.4643 prot. datë 10.11.2023 të paraqitur nga **Z.Defrim Tafa**, i cili kërkon ndihmë financiare pasi bashkëshortja e tij Zj. Enkeleda Tafa është egzaminuar me një sëmundje të rëndë “mase tumorale Menigeoma P-O dex”.

Shtetësi në fjalë shprehet me anë të kërkesës së tij se si rezultat i egzaminimit dhe konsultave të mjekëve Zj. Enkeleda Tafa iu nënshtrua ndërhyrjes kirurgjikale e vërtetuar kjo nga Kartela Mjekësore lëshuar nga Spitali Nr. 5 në Qëndën Spitalore Universitare Nënë Tereza dhe e ka të pamundur përballimin nga ana financiare kostove të operacionit dhe të kurimit të vazhdueshëm për trajtimin e sëmundjes pasi të dy bashkëshortët janë të papunë, kanë tre fëmijë të mitur dhe trajtohen vetëm me një ndihmë ekonomike nga Bashkia Gramsh.

Bashkia Gramsh me kërkesën e bërë nga Z. Defrim Tafa, ku shprehet se bashkëshortja e tij paraqitet me sëmundje të rëndë ndoshta edhe të pashërueshme e cila nuk ka mundësi për përballimin e shpenzimeve te operacionit dhe për kurimin e vazhdueshëm, mendon ti vijë në ndihmë e ti ofroj një ndihmë financiare prej 100.000 lekë për ti lehtësuar sado pak pamundësinë e saj financiare dhe vështirësitë në të cilat gjenden.

Bashkangjitur gjeni dokumentacionin provues për rastin ne fjalë.

1. Kërkesa
2. Karta e identitetit
3. Përmbledhje e Kartelës Mjekësore nga Spitali Nr. 5 në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza”
4. Foto të pacientit para dhe pas ndërhyrjes kirurgjikale.

KRYETARI

Besion AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH



Nr. 40877 prot.

Gramsh, më 21/11/2023

P/VENDIM

Nr. ___ Datë ___. ___. 2025

PËR
DHËNIE SHPËRBLIMI NGA FONDI REZERVË PËR PËRBALLIMIN E
SHPENZIMEVE PËR KURIM

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës datë __.11.2023 pasi mori në shqyrtim , kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga **Z.Defrim Tafa**, për miratimin e përdorimit të pjeshëm nga fondi rezervë të planit të buxhetit 2023, mbështetur në Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar, në ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ligjit nr.84/2022 datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” i ndryshuar si dhe ligjin 139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore “ neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 gërma “b”, neni 54 gërma “dh”

VENDOSI :

1. Dhënien e masës së shpërblimit në masën 100.000 lekë (njëqind mijë lekë) nga fondi rezervë për **Z.Defrim Tafa** për të përballuar kurimin e bashkëshortes së tij.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

SEKRETARI KËSHILLIT

KRYETARI I KËSHILLIT

XHULIA GJINI

ENIS ZANI